

Armë zjarri AK-47, pushkë ajrore dhe pistoletë i gjenden në shtëpi– arrestohet një person në Prishtinë



10/09/2025 09:27

f

t

Një person është arrestuar në rrugën “Viktor Hygo” në Prishtinë, pasi gjatë një kontrolli në shtëpinë e tij, Policia e Kosovës ka zbuluar dhe konfiskuar një arsenal armësh, përfshirë një armë automatike AK-47.

Ngjarja ka ndodhur më 09 shtator 2025, rreth orës 14:50, dhe gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar: një armë zjarri AK/47, një pushkë ajrore, një pistoletë, dy karikatorë të pistoletës dhe nëntë fishekë, transmeton [lajmi.net](#).

Përveç të dyshuarit kryesor, në lidhje me rastin janë intervistuar edhe dy persona tjerë – një mashkull dhe një femër, të dy shtetas kosovarë.

Pas intervistimit, me vendim të prokurorit, të gjithë të dyshuarit janë liruar, ndërsa rasti do të ndiqet në procedurë të rregullt.

Policia ka konfiskuar të gjitha armët dhe provat materiale, ndërkohë që hetimet lidhur me posedimin e paautorizuar të armëve po vazhdojnë./[lajmi.net/](#)

LAJME TË FUNDIT

Osmani iu referua “informacioneve të sigurisë” në reagimin...

Kusari i reagon Osmanit: Raportimi për përdorimin e...

Dua Lipa një nga personat e parë në...

“Here we go”: Vjen reagimi i Trump, pasi...

Artikuj të ngjashëm



September 10, 2025
Osmani iu referua “informacioneve të sigurisë” në reagimin e saj, AGK...

Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information